



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi 03/2014

VLERËSIMI I TRAJNIMEVE DHE NJOHURIVE TË ZYRTARËVE POLICOR LIDHUR ME PËRDORIMIN E FORCËS POLICORE



2014

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
DPP	Drejtoria e Përgjthshme e Policisë
DRP	Drejtoria Regjionale e Policisë
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PK -së	Policia e Kosovës

P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2. HYRJE

3. TË GJETURAT

3.1 Organizimi i Policisë në fushën e Trajnimit për përdorimin e forcës fizike

3.2 Vlerësimi i Bazës ligjore në fushën e trajnimit mbi përdorimin e forcës;

3.3 Vlerësimi i Gjendjes së vijueshmërisë me trajnimin e përdorimit të forcës;

3.4 Vlerësimi i Performancës policore gjatë përdorimit të forcës nga Policia;

4. PËRFUNDIMET

5. REKOMANDIMET

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231 dhe autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë një inspektim të rregullt në fushën e trajnimeve mbi përdorimin e forcës me temën “Vlerësimi i trajnimeve dhe njohurive të zyrtarëve policor lidhur me përdorimin e forcës”. Inspektimi në këtë fushë është shtrirë në strukturën policore dhe si i tillë ka përfshirë Divizionin e Trajnimeve në kuadër të DPP-së, shtatë Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës dhe shtatëmbëdhjetë stacione policore.

1.2 Inspektimit në këtë fushë i ka parapri faza hulumtuese e cila ka filluar me datë 20.02.2014, si dhe hartimi i programit inspektues përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Programi i punës inspektuese ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren prej datës 28 mars deri më 14 maj 2014. Periudha e vlerësuar në këtë raport përfshin periudhën kalendarike një vjeçare të punës, konkretisht ka përfshi periudhën prej 01.01.2013 deri më 31.12.2013.

1.3 Pajisja e personelit policor me trajnime në fushën e përdorimit të forcës realizohet në kuadër të tri programeve trajnuese: programit të trajnimit bazik për kadetët policor ku secili zyrtar policor iu ka nënshtruar një trajnimi të tillë; programi i ricertifikimit që është obligativ për secilin zyrtarë policor; programi i trajnimit të brendshëm prej 40 orësh brenda një viti nëse si temë ishte futur fusha e përdorimit të forcës.

1.4 Sipas strukturës organizative të Policisë së Kosovës në fuqi, përgjegjës për organizimin e trajnimeve mbi përdorimin e forcës nga policia janë Divizioni i Trajnimeve në DPP si dhe Zyrrat Regjionale për Trajnime në kuadër të Sektorit të Administratës Regjionale. Ndërsa ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur.

1.5 Të gjeturat tregojnë se infrastruktura ligjore konkretisht Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 që rregullon fushën e përdorimit të forcës është i përcjellur me mospërputhshmëri në mes përkufizimit të përdorimit të forcës, raportimit të saj dhe formularit për përdorimin e forcës. Për sqarime të mëtejme, **Udhëzimit Administrativ 2/2012 për përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë** në kuadër të përkufizimeve nuk e defininon se çka nënkupton “**forcë fizike**” e cila është kategori e përkufizimit të përdorimit të forcës. Po ashtu, formulari për përdorimin e forcës nuk parasheh raportim të përdorimit të forcës tek përdorimi i **mjeteve pranguese**, si rezultat i së cilës ka një diferencë në mes plotësimit të formularëve për përdorimin e forcës dhe personave të arrestuar .

1.6 Në përgjithësi Drejtoritë Rajonale të PK-së gjatë vitit 2013, janë përballur me mangësi në qëshhtë organizative dhe procedurale. Në përjashtim të DRP-Prizren dhe DRP-Prishtinë, të dhënat tregojnë pjesëmarrje jo të kënaqshme të zyrtarëve policor në ricertifikim, trajnimet e brendshme mjaft pak kanë futur si temë përdorimin e forcës deri sa pyetësori i cili iu është shpërndarë zyrtarëve policor për vlerësimin e njohurive mbi fushën e përdorimit të forcës policore, kanë treguar se 49.89% nga zyrtarët policor që janë nënshtruar këtij pyetësori kanë dhënë përgjigje pozitive (të sakta) kurse 50.11% e përgjigjeve kanë qenë negative (jo të sakta). Ndërsa tek të gjitha drejtoritë rajonale ekzistojnë mënyra të ndryshme të menaxhimit dhe arkivimit të dosjeve të përdorimit të forcës.

1.7 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 13.08.2014, ka mbajtur edhe takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të

gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura dhe se nuk ka asnjë pikë e cila do të mundë të kontestohet.

1.8 Me datën 08.09.2014, IPK-ja ka pranuar nga Departamenti i Operacioneve, Planin e veprimit në realizimin e rekomandimeve, në të cilin është konstatuar se disa nga rekomandimet e dhëna në raport janë realizuar, derisa disa të tjera janë në proces të përmbushjes.

2. HYRJE

2.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, paragrafi 2, autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka bërë Inspektim të zakonshëm në Policinë e Kosovës. Inspektimi u funksionalizua nga inspektorët policor të Departamentit të Inspektimit dhe është zhvilluar nga data 28 mars deri me 14 maj 2014.

2.2 Udhëzimi Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policor, përcakton rregullat lidhur me përdorimin e forcës nga policia ndaj personave apo qytetarëve dhe shqyrtimin e përdorimit të kësaj force. Duke u bazuar në nevojën e respektimit të rregullave të shkruara, numrin e ankesave të qytetarëve kundër zyrtarëve policor për tejkallim të autorizimeve policore dhe nivelit të përdorimit të forcës gjatë kryerjes së detyrave policore, IPK-ja në sajë të autorizimeve që i jep ligji e sheh të nevojës të kryej inspektim në këtë fushë. Andaj qëllimi i këtij inspektimit është që:

- Të vlerësoj se programet trajnuese të ofruar për zyrtaret policor operativ janë efikase, efektive dhe njohuritë e përvojat e përfituara shërbejnë drejtë ngritjes së performancës policore gjatë kryerjes së aktiviteteve policore;
- të vlerësohet se kryerja e detyrave nga punonjësit policor operativ, është në pajtim me rregullat dhe procedurat mbi mënyrën e përdorimit të forcës ndaj personave më qëllim të realizimit të objektivave të policisë, të përcaktuara me dispozitat ligjore;
- të bëjë identifikimin dhe parandalimin e mangësive apo parregullsive gjatë aplikimit të trajnimeve në temat mbi përdorimin e forcës, si dhe
- të jepen rekomandime për përmirësimin e performancës policore, ngritje e nivelit të profesionalizmit dhe disiplinës tek zyrtarët policor gjatë kryerjes së detyrave policore.

2.3 Objektivat që synon të arrij ky inspektim janë:

- Vlerësimi i bazës ligjore në fushën e trajnimit mbi përdorimin e forcës.
- Vlerësimi i gjendjes së vijueshmërisë me trajnime dhe njohuri për përdorimin e forcës tek zyrtarët policor.
- Vlerësimi i performancës policore gjatë përdorimit të forcës nga Policia e Kosovës.

2.4 Periudha e Mbulimit në këtë fushë të inspektimit përfshinë periudhën prej 01.01.2013 deri më 31.12.2013.

2.5 Dokumentet në vijim do të jenë baza në të cilën do të mbështetet puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të detyrave policore në drejtoritë gjegjëse:

- Ligji i Policisë së Kosovës- 04/L-076 (neni 26 dhe 55);
- Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 Për Përdorimin e forcës policore nga zyrtarët policorë;
- Doracaku i Parimeve dhe Procedurave(Seksioni VIII/P.8.14 dhe P.815)

2.6 Inspektimi në këtë fushë luan rol të rëndësishëm:

- Duke siguruar se programet trajnuese në fushën e përdorimit të forcës shërbejnë drejtë zhvillimit dhe përfitimit të njohurive për zyrtarët policor.
- Përmirësimin e kryerjes së detyrave policore duke siguruar ngritje të performancës policor në harmoni me standardet e kërkuara.

- Identifikimin dhe parandalimin e parregullsive gjatë procedurave të përdorimit të forcës dhe ngritjen e nivelit të profesionalizmit
- Ngritjen e nivelit të përgjegjësisë dhe disiplinës së zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së detyrave policore.

2.7 Metodologjia: Gjatë këtij inspektimi është aplikuar metodologji e punës e kombinimit të intervistave me zyrtarët kompetent për fushën që inspektohet, kontrollimi fizik i dokumentacionit të shkruar relevant gjatë procesit të inspektimit brenda periudhës që i kushtohet inspektimi dhe plotësimi i nëntëdhjetë e katër (94) pyetësorëve nga zyrtarët policor për të vlerësuar nivelin e përgjithshëm të njohurive sa i përket përdorimit të forcës. Për trajtim të mëtejme po ashtu nëpër Drejtori Rajonale dhe Stacione policore janë marrë dhe kontrolluar proporcionalisht 54 kopje të lëndëve të përdorimit të forcës nga policia.

2.8 Inspektimin në këtë fushë është shtrirë në Strukturën policore dhe si i tillë ka përfshirë Divizionin e Trajnimeve në kuadër të DPP-së, 7 (shtatë) Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) stacione policore. Gjatë inspektimit në Divizionin për Trajnime dhe në Drejtoritë Rajonale të Policisë së Kosovës, personeli i IPK-së ka intervistuar zyrtarët si në vijim:

- Drejtori i Divizionit të Trajnimeve
- Drejtori i Drejtorisë për Trajnime Mandatore
- Trajner Policor në Drejtorinë për Trajnime Mandatore
- Shefat e Sektorit Rajonal për Administratë
- Shefat e Sektorit Rajonal për Operativë
- Zyrtari Përgjegjes për Trajnime në DRP
- Trajner Policor në DRP
- Oficer Policor Operativ

3. TË GJETURAT

3.1 Organizimi i Policisë së Kosovës në fushën e Trajnimeve të Përdorimit të Forcës

3.1.1 Sipas Strukturës Organizative të Policisë së Kosovës në fuqi, përgjegjës për organizimin e trajnimeve mbi përdorimin e forcës nga policia janë Divizioni i Trajnimeve në DPP si dhe Zyrat Regjionale për Trajnime në kuadër të Sektorit të Administratës Regjionale. Divizioni i Trajnimeve i Policisë së Kosovës është kompetent për normat dhe përpilimin e programeve për të gjithë trajnimet si dhe ndryshimet eventuale të tyre, kurse zyrat regjionale të trajnimeve janë kompetente për zbatimin e këtyre programeve trajnuese si dhe mund të propozojnë temat për trajnimet sipas identifikimit të nevojave dhe kërkesave të tyre. Temat e propozuara nga drejtoritë rajonale për trajnimet e brendshme shqyrtohen nga Divizioni i Trajnimeve dhe nëse aprovohen si të tilla, ky i fundit harton programet mësimore dhe ja dorëzon Drejtorive Regjionale për zbatim.

3.1.2 Pajisja e personelit policor me trajnime në fushën e përdorimit të forcës realizohet në kuadër të tri programeve trajnuese: programit të trajnimit bazik për kadetët policor, programi i ricertifikimit dhe programi i trajnimit të brendshëm prej 40 orësh brenda një viti, nëse si temë ishte futur fusha e përdorimit të forcës.

3.1.3 Në kuadër të kursit bazik të Policisë që aplikohet për kadetët policorë është i aplikuar programi mësimor mbi përdorimin e forcës nga policia ku ky program ka si qëllim kryesor informimin me rregulla dhe procedura standarde për mënyrën e përdorimit të forcës nga zyrtarët policor ndaj personave, me qëllim të arritjes së objektivit të Policisë të përcaktuara me dispozita ligjore, si dhe shqyrtimin e rasteve të përdorimit të forcës me qëllim të konstatimit të ligjshmërisë. Gjatë vijimit të orëve të mësimi nga ky planprogram trajnues studentët (kadetët policor) përfitojnë këto njohuri:

- a) Njoftohen me rregulat dhe procedurat e përdorimit të forcës nga zyrtarët policor;
- b) Informohen me përdorimin e pajisjeve policore dhe mjeteve tjera;
- c) Informohen me detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë Speciale Intervenuese (NJSI);
- d) Kuptojnë rolin e Komisionit për Shqyrtim të Përdorimit të Forcës;¹

3.1.4 Në kuadër të planprogramit të ricertifikimit nëpër të gjitha Drejtoritë Rajonale të policisë është krijuar infrastrukturë për vijimin e kursit të ricertifikimit brenda drejtorive rajonale. Andaj, ky proces deri në vitin 2014 për zyrtarët policor të pagraduar është mbajtur në kuadër të DRP-ve, ndërsa ricertifikimi për stafin e graduar është realizuar në kuadër të AKSP-së. Kurse nga viti 2014, kursi i ricertifikimit deri në gradën e Kapitenit organizohet në kuadër të Drejtorive Regjionale të PK-së.

3.1.5 Në kuadër të programit të trajnimeve të brendshme (40 orësh) për vitin 2013, fusha e përdorimit të forcës nga policia shumë pak ishte futur si temë e trajnimit në kuadër të planprogramit trajnues të brendshëm. Mirëpo vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe ishin organizuar trajnime të brendshme ku disa tema kishin ndërlidhje direkte apo indirekt me fushën e përdorimit të forcës si: Arrestimi, Ndalimi, Paraburgimi etj.

¹ Policia e Kosovës, Divizioni i Trajnimeve/Kursi Themelor për Policinë e Përgjithshme/Mesimi #2.2 Përdorimi i forcës nga zyrtarët policor;

3.1.6 Planprogramet mësimore të trajnimeve të brendshme mbi përdorimin e forcës më së shumti janë metodologji teorike e të aplikuarit dhe ka vërejtje se atyre plangprogrameve ju mungojnë aplikimi i skenarëve dhe situatave praktike.

3.2 Vlerësimi i bazëz ligjore në fushën e trajnimit mbi përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë

3.2.1 Normativa ligjore që rregullon fushën e përdorimit të forcës në Policinë e Kosovës janë normat që dalin nga Ligji i Policisë së Kosovës 04/L-076 konkretisht neni 26 i këtij ligji dhe Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 Për përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë. Rregullativa ligjore konkretisht Udhëzimi Administrativ 02/2012 ka të rregulluar në mënyrë të detajuar qështjen e përdorimit të forcës nga zyrtarët policor, por që gjatë analizimit është vërejtuar se ka mospërputhje në mes përkuzimit të përdorimit të forcës, raportimit të përdorimi të forcës, dhe formularit për përdorimin e forcës.

3.2.2 Kështu që **Neni 2** i udhëzimit ka përcaktuar përkufizimin e përdorimi të forcës sipas të cilit *“Përdorimi i forcës- nënkupton përdorimin e forcës mbi personat si veprim i drejtëpërdrejtë nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve, mjeteve tjera apo armëve të zjarrit”*². Më tutje udhëzimi ka përfillur rrjedhën e trajtimit të përkufizimit të përdorimi të forcës duke shpjeguar në mënyrë të detajuar në nene të veçanta qështjen e pajisjeve, mjeteve tjera apo armët e zjarrit, por duke lënë hapsirë ligjore në mos trajtim të qështjes së **“forcës fizike”** si kategori e përkufizimit të përdorimit të forcës.

3.2.3 Ndërsa neni 21 i udhëzimit ka të rregulluar raportimin e përdorimi të forcës sipa të cilit përkufizim *“Raportimi – nënkupton që zyrtari policor i cili përdor **forcën fizike** menjëherë pas incidentit, apo sa më shpejtë që të jetë e mundur pas incidentit është i obliguar që ta raportoj përdorimin e forcës në formularin e përdorimit të forcës, i cili formualr si shtojcë-aneks do ti bashkëngjitet udhëzimit administrativ (Ankesin “A” i këtij udhëzimi)”*³. Kështu që raportimi si rregullativ e njeh si kategori të përkufizimit të përdorimit të forcës vetëm forcën fizike e cila siç është potencuar në paragrafin më lartë nuk është e trajtuar fare në udhëzimin administrativ.

3.2.4 Për më tutje, formulari standard për rastet e raportimit të përdorimit të forcës tek rubrika e përshkrimit të forcës së përdorur përfshinë si në citat: *“Niveli i forcës së Përdorur (Evidento të gjitha që janë përdorur): Verbale; Me duar thatë; OC Sprej; Goditje; Shkopi; Forca Vdekjeprurëse”*⁴. Në kuadër të kësaj rubrike disa nga pajisjet policore dhe mjetet tjera nuk janë të përshira në formular, kështu që formulari brenda vetës ka selektuar disa nga qështjet e përdorimit të forcës dhe ka përjashtuar disa nga to. Por, kjo qështje në veçanti ka shkaktuar boshllëk tek rrethana e përdorimit të **mjeteve pranguese** ku sipas **Nenit 6** të Udhëzimi Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë definon *“Mjetet pranguese janë pajisje të cilat përdorën nga zyrtarët policor në këto raste: a) për të arrestur ose ndaluar personin e dyshimtë; b) për ta mënjanuar sulmin e drejtuar kundër zyrtarit policorë apo ndonjë personi tjetër; c) për ta penguar rezistencën e ndonjë personi; d) për ta penguar ikjen e personit të dyshimt dhe e) për ta pamundësuar vetëlëndimin ose lëndimin e ndonjë personi tjetër”*⁵. Andaj, kjo mospërfshirje e **mjeteve pranguese** në Formularin e Përdorimit të forcës ka krijuar huti tek zyrtarët policorë

² Udhëzimi Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë (Neni 2)

³ Udhëzimi Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë (Neni 21)

⁴ Aneksi “A” Formulari për përdorimin e forcës

⁵ Udhëzimi Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë (Neni 6)

në teren se a duhet të raportohet përdorimi i forcës tek rastet e përdorimit të mjeteve pranguese.

3.2.5 Në përputhje me normat e Udhëzimit Administrativ 2/2012, në Policinë e Kosovës qështja e trajnimeve për njohuritë në fushën e përdorimit të forcës ndahet në tri periudha, atë të kursit bazik, ricertifikimit si dhe trajnimet e obliguara në drejtorit rajonale për zyrtarët policor dhe të cilat në fushën e përdorimit të forcës mund të dalin si rezultat i nevojave. Që të gjitha programet trajnuese për përdorimin e forcës që janë cekur më lartë dhe që dalin si kategori e bazës ligjore, përmbajnë në vete broshura(kurrikolume) të cilat do të duhej të rrjedhin në mënyrë të harmonizuar me të gjitha aktet ligjore që rregullojnë fushën e përdorimit të forcës.

3.2.6 Kështu që në kuadër të kursit bazik të Policisë për kadetët policorë është i aplikuar programi mësimor (trajnimet) mbi përdorimin e forcës nga policia, ku ky program ka si qëllim kryesor informimin me rregulla dhe procedura standarde për mënyrën e përdorimit të forcës fizike nga zyrtarët policor ndaj personave, me qëllim të arritjes së objektivit të Policisë, të përcaktuara me dispozita ligjore, si dhe shqyrtimin e rasteve të përdorimit të forcës me qëllim të konstatimit të ligjshmërisë.

3.2.7 Ndërsa sa i përket programit të ricertifikimit për Policinë e Kosovës secili zyrtar policor brenda periudhës 10 deri 14 muaj duhet ti nënshtrohet procesit të ricertifikimit. Programi i trajnimit të ricertifikimit mbulon fushën e përdorimit të Armëve të zjarrit, vetëdijesimin mbi sigurinë, taktikat mbrojtëse, ndihma e parë dhe mirësjelljen e policit. Sipas dispozitave të dala nga parimi P.8.14 programi i ricertifikimit është i ndarë në katër (4) kategori sipas niveleve të gradës policore: a) Programi i trajnimit të ricertifikimit për polic; b) Programi i ricertifikimit për Rreshter; c) Programi i ricertifikimit për Toger dhe Kapiten; d) Programi i ricertifikimit për Major, Nënkolonel dhe Kolonel.

3.2.8 Program tjetër të veçant të trajnimit të ricertifikimit sipas këtij parimi aplikohet për zyrtarët policor të Njësisë K-9, zyrtarët policor që punojnë në Njësitë Operative Speciale, zyrtarët policor që punojnë në Njësinë Speciale Intervenuese dhe zyrtarët policor që punojnë në Njësinë e Mbrojtjes së Afërt.

3.2.9 Po ashtu, drejtoritë rajonale policore janë të obliguara që për secilin zyrtar policor të ofrojnë fondin prej 40 orë trajnimi të brendshëm me temat që dalin si rezultat identifikimit të nevojave që burojnë nga vetë stacionet dhe njësitë policore, ku realisht ka mundësi që të trajtohen temat e përdorimit të forcës nga ana e zyrtarëve policor.

3.2.10 Të gjitha programet (trajnimet) mësimore të cilat pasojnë me përplimin e broshurave (kurrikolumeve) janë në përputhje të plotë me bazen ligjore për përdorimin e forcës dhe të cilat rrjedhin nga dokumentet e Policisë së Kosovës. Ky program mësimor realizohet në kombinim në mes të mësimi teorik dhe praktikë.

3.2.11 Gjatë inspektimit në teren është vërejtur mungesa e egzistimit të një Procedure standarde të operimit lidhur me proceduarat e veprimit policor në rastet e përdorimit të forcës nga policia. Kjo procedurë do duhej të detajonte qartë hapat veprues të zyrtarëve policorë gjatë procedurave të përdorimit të forcës.

3. Vlerësimi i gjendjes së vijueshmërisë së trajnimeve të përdorimit të forcës

3.3.1 Pajisja e personelit policor me trajnime në fushën e përdorimit të forcës realizohet në kuadër të programit të trajnimit bazik për kadetët policor ku secili zyrtar policor ju ka nënshtruar një trajnimi të tillë pas pranimit si pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe i nënshtrohet programit trajnues që aplikohet për kadetët policorë në të cilin janë të inkuorpuara edhe temat e fushës së përdorimit të forcës nga policia.

3.3.2 Sa i përket përfshirjes së personelit në trajnimin e ricertifikimit gjendja dallon nga regionin në region për arsye se disa regjione, trajnimin e ricertifikimit në vitin 2013, e kanë organizuar vetëm për gradën e oficerit policor si rasti i DRP-se në Ferizaj, ndërsa në DRP-Gjilan, DRP- Pejë, DRP- Prizren, procesin e ricertifikimit deri në gradën e kapitenit e kanë përfunduar në kuadër të DRP-ve, ndërsa për gradat më të larta këtë proces e kanë përfunduar në AKSP. Kjo dukuri ka ndodhur deri në vitin 2014, ngase struktura policore ka qenë duke e përgaditur infrastrukturën nëpër Drejtori Regjionale, në mënyrë që procesi i ricertifikimit nga AKSP-ja të bartet nëpër Drejtori Regjionale të PK-së. Kurse në DRP Mitrovicë e Jugut trajnimin e ricertifikimit ende e ndjekin në kuadër të AKSP-së.

Nr	Regjionet	Zyrtar policor	Zyrtar të ricertifikuar	% e zyrtarëve të ricertifikuar
1	Prishtina	967	874	90.4
2	Prizreni	638	596	93.4
3	Ferizaj	422	238	56.4
4	Mitrovica e Jugut	467	239	51.2
5	Mitrovica e Veriut ⁷	144	/	/
6	Gjilan	464	408	88
7	Pejë	688	614	89.2
8	Gjithsejtë	3790	2969	78.3

3.3.3 Bazuar nga të dhënat që dalin nga raportet periodike të Drejtorive Rajonale për vitin 2013, nivelin më të lartë në kursin për ricertifikimin e kanë vijuar si në tabelën nr.1. Drejtorija Regjionale e Prizrenit dhe Drejtorija Rajonale Prishtinë. Andaj sipas të dhënave shihet se këto dy drejtori kanë arritur realizueshmërinë e trajnimit të ricertifikimit për vitin 2013, me 93.4 % gjegjësisht me 90.4 %. Realizueshmërinë e trajnimit të ricertifikimit më të ulët për vitin 2013, kanë pasur Drejtorija Regjionale e Mitrovicës së Jugut dhe ajo e Ferizajit me 51.2% respektivisht 56.4%.

Sa i përket Mitrovicës së Veriut, rasti është i ndërlikuar ngase Drejtorija Regjionale e Mitrovicës së Veriut është krijuar në vitin 2013, dhe për arsye tash të njohura të situatës së krijuar atje gjatë kësaj periudhe ka pasur ngecje dhe mos përfshirje të personelit në procesin e ricertifikimit nga personeli i stacioneve policore nga Veriu i Mitrovicës.

⁶ Të dhënat statistikore janë siguruar nga Drejtoritë Regjionale të PK-së gjatë fazës së inspektimit në teren;

⁷ Të dhënat për DRP Mitrovica e Veriut mungojnë për shkak se kjo e fundit në vitin 2013 është krijuar si Drejtori e ndarë nga Drejtorija Rajonale e Mitrovicës;

3.3.4 Bazuar në intervistat e realizuara me menaxherët e përfshirë në procesin e inspektimit, motivimi i personelit për vijueshmëri të trajnimeve vlerësohet të jetë i nivelit jo të kënaqshëm. Këtë gjendje këta menaxher e arsyejnë me kushtet jo të kënaqshme që ju ofrohet zyrtarëve që vijojnë trajnimet, si p.sh në kursin e ricertifikimit i cili kurs ka filluar të mbahet nëpër drejtoritë rajonale zyrtarët policor ballafaqohen me kushte jo të mira të punës gjatë kohës sa janë në ushtrime praktike në salla dhe në poligonin e gjuajtjes. Atyre nga PK-së, nuk iu ofrohet ushqim as ujë i pijës, çka e vështirëson qëndrimin e tyre dhe ulë mjaftë motivimin për trajnim.

3.3.5 Bazuar nga identifikimi i nevojave për trajnimet e brendshme Drejtoritë Rajonale Policore në përputhje me parimin P-8.15 janë të obliguara që të përmbushin normën prej 40 - orë trajnim ku stacionet dhe njësitë policore kanë mundësi që të propozojnë tema dhe fusha varësisht se ku ata ndien nevojë për të përmirësuar njohuritë e zyrtarëve policore për fusha të caktuara. Nga të dhënat e nxjerra nga inspektimi, fusha e përdorimit të forcës gjatë vitit 2013, ishte përfshirë shumë pak si temë në kuadër të trajnimeve të brendshme prej 40 orësh.

3.3.6 Divizioni i Trajnimeve të PK-së gjatë inspektimit ka ofruar të dhëna për miratimin e fushave të trajnimeve të brendshme që lidhen me përdorimin e forcës direkte apo indirekte dhe si e tillë ka nxjerrë një plan program trajnues për të gjitha drejtoritë rajonale të policisë dhe stacionet policore, për periudhën e realizueshmërisë prej korrikut 2013 deri në qershorin 2014.

Andaj, gjatë periudhës sa zhvillohej inspektimi realizueshmëria e planprogramit të trajnimeve të brendshme në kuadër të DRP-ve, ka qenë duke vazhduar deri në përmbushjen e këtij plani.

3.3.7 Trajnimet që janë paraparë nga divizioni i trajnimeve të PK-së për periudhën kohore korrik 2013 deri në qershor 2014, dhe që ndërlidhen apo reflektojnë në ofrimin e njohurive të zyrtarëve policor mbi fushën e përdorimit të forcës përfshijnë: Përdorimi i forcës nga zyrtarët policor, Njohuritë mbi udhëzimet administrative në fuqi nga kjo fushë, Kontrollimi i personave, Procedurat e arrestimit dhe ndalimit, Arrestimi dhe paraburgimi, Ligji për armët, Procedurat e arrestimit dhe paraburgimi i personave të mitur etj.

3.3.8 Në tabelën në vijim pasqyrohet fondi i orëve të planifikuara për trajnime të brendshme që ndërlidhen me fushën e përdorimit të forcës për periudhën kohore korrik 2013 deri në qershor 2014. Sipas këtij planprogrami trajnues Drejtoria Regjionale e Prishtinës, Drejtoria Regjionale e Mitrovicë- Jugut, Drejtoria Regjionale Gjilan dhe Drejtoria Regjionale Prizren, përfshijnë 40 e më shumë orë për këto tema, ndërsa Drejtoria Rajonale e Pejës dhe ajo e Ferizajt kanë paraparë një fond me të ulët të orëve për këto fusha nga 7 respektivisht 10 orë.

Tabela nr. 2. Fondi i orëve që ndërlidhen me fushën përdorimit të forcës në kuadër të trajnimeve të brendshme gjatë periudhës korrik 2013- qershor 2014⁸	
Drejtoria	Numri i orëve
DRP-Mitrovica e Jugut	40 orë
DRP-Gjilani	45 orë
DRP- Peja	7 orë
DRP-Prishtina	43 orë
DRP-Prizren	40 orë
DRP-Ferizaj	10 orë
DRP-Mitrovica e Veriut	/

⁸ Të dhënat statistikore janë siguruar nga Divizioni i Trajnimeve në kuadër të DPP-së gjatë fazës së inspektimit në teren;

3.3.9 Për realizimin e planifikimit vjetor të programit trajnues të trajnimeve të brendshme janë të shpërndarë personel i certifikuar nga Divizioni i trajnimeve për instruktor, si dhe trajner policor të cilët janë të shpërndarë nëpër njësi dhe stacione policore në kuadër të DRP-ve të PK-së. Tabela në vijim pasqyron shpërndarjen e instruktorëve policor për trajnime të brendshme sipas drejtorive rajonale në raport me numrin e personelit të uniformuar policor. Në bazë të këtyre të dhënave të mbledhura gjatë inspektimit numër më të vogël të personelit të certifikuar për trajner kanë Drejtoria Rajonale e Ferizajit ajo e Gjilanit si dhe Drejtoria Mitrovicës së Veriut e cila është formuar së voni si drejtori e re. Kështu që sa i përket Drejtorisë Rajonale Mitrovicë- Veriu në bazë të intervistave me menaxherët regional dhe ata të stacioneve policore, kanë vetem 2 zyrtarë të certifikuar për trajner policor. Marrë në përgjithësi numrin e zyrtarëve policor të shpërndarë nëpër DRP nga 3720 prej tyre, si personel i certifikuar për trajnerë janë 157 apo 4.2 %.

Tabela nr. 3. Shpërndaria e instruktoreve (trajner) nëpër Drejtori Rajonale të PK-së			
Drejtoria	Numri i personelit të uniformuar	Numri i trajnereve	%
DRP-Mitrovica e Jugut	501	21	4.2
DRP-Gjilan	464	11	2.4
DRP- Pejë	576	45	7.8
DRP-Prishtinë	993	41	4.1
DRP-Prizren	504	31	6.1
DRP-Ferizaj	383	6	1.6
DRP-Mitrovica e Veriut ⁹	299	2	0.7
Total	3720	157	4.2

3.3.10 Gjatë inspektimit në këtë fushë në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Mitrovicën e Veriut menaxherët policor në kuadër të Drejtorisë Regjionale si dhe ata të stacioneve policore, ngritën shqetësimin se personeli policor i angazhuar në kuadër të kësaj të fundit për shkak të situatës së krijuar në këtë pjesë kanë mbetur shumë mbrapa me realizimin e trajnimeve të përgjithshme policore për stafin e tyre, e në veçanti kanë shprehur brengën se personeli i ri ka mungesë të trajnimeve sa i përket njohurive dhe përvojave policore në fushën e përdorimit të forcës.

3.4 Vlerësimi Performancës policore gjatë përdorimit të forcës nga policia

3.4.1 Sipas **Nenit 21** Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 Për përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë “zyrtari policor, i cili e përdorë forcën fizike menjëherë pas incidentit, apo sa më shpejtë që të jetë e mundur pas incidentit është i obliguar që të raportoj përdorimin e forcës në formularin e përdorimit të forcës. Formulari plotësohet në bashkëpunim me mbikëqyrësin e tij. Nëse për shkak të lëndimit , zyrtari policor është në pamundësi që ta plotësoj, atëherë formulari duhet të plotësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë”¹⁰. Nga të dhënat që dalin si rezultat i inspektimit në teren zyrtarët policor të përfshirë në përdorim force menjëherë pas incidentit brenda 24 orësh apo më së largu 72 orë (në rast ditëve të vikendit), raportojnë me një raport me shkrim tek mbikëqyrësit e tyre përdorimin e forcës. Mbikëqyrësit e zyrtarëve policor që kanë raportuar përdorimin e forcës në bashkëpunim me zyrtarin e përfshirë në përdorimin e forcës plotësojnë formularin për përdorimin e forcës dhe të njëjtës i’a bashkëngjitin një memo të cilën përmes

⁹ Të dhënat për DRP Mitrovica e Veriut mungojnë për shkak se kjo e fundit në vitin 2013 është krijuar si Drejtori e ndarë nga Drejtoria Rajonale e Mitrovicës;

¹⁰ Udhëzimi Administrativ Nr.02/2012 Për përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë;

operativës së stacionit i dërgohet komandantit të stacionit i cili e përcjellë atë nëpërmes Divizionit të Administratës Regjionale/Drejtorisë Regjionale, tek Komisioni për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës, në kuadër të DPP-së. Vijë të njëjtë sipas zingjirit komandues ndjeket edhe me rastin kur komisioni nxjerrë vendimin për shqyrtimin e përdorimit të forcës.

3.4.2 Nëpër DRP-së, dhe stacione policore është praktikë që raportimi i forcës nga zyrtarët policor të aplikohet vetëm në rastet kur subjekti i cili ballafaqohet me policinë ushtron rezistencë ndaj urdhërave policore me rastin e intervenimit policor.

3.4.3 Përdorimi i **mjeteve pranguese** nga policia pothuajse nuk raportohet fare si përdorim i forcës ngase dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2012 Për përdorimin e forcës nga zyrtarët policorë kanë krijuar paqartësi pasi që mjetet pranguese nuk janë të inkorporuara si mjete të përdorimit të forcës, në kuadër të formularit të përdorimit të forcës. Numri i rasteve të raportuar të përdorimit të forcës nuk korespondojnë as për së afërmi me numrin e personave të arrestuar/prangosur. Bazuar nga praktika në teren rastet e përdorimit të forcës nga policia shumica prej tyre përfundojnë më arrestimin e personave. Po ashtu tek vendosja e mjeteve pranguese, jo rrallë herë personit që i vihen prangat reziston dhe refuzon vendosjen e tyre andaj shpeshherë policia ballafaqohet me nevojën e përdorimit të forcës për të shtirë nën kontrollë subjektet e tilla. Andaj, kjo rrethanë ka qenë arsye e cila ka shtyrë që të bëhet krahasimi i të dhënave të numrit të rasteve të iniciuara të përdorimit të forcës me numrin e personave të arrestuar.

Në tabelën në vijim paraqesim numrin e rasteve të raportuara të përdorimit të forcës nga policia në raport me numrin e personave të arrestuar për vitin 2013, sipas drejtorive regjionale të policisë.

Tabela nr.4 Krahasimi i rasteve të raportimit të përdorimit të forcës me numrin e personave të arrestuar sipas Drejtorive Regjionale të PK-së për vitin 2013¹¹			
Drejtoria	Numri i Personave të arrestuar	Numri i rasteve të raportuara të P.F	%
DRP-Mitrovica e J	3038	47	1.5
DRP-Gjilani	1493	16	1.1
DRP- Peja	5972	33	0.5
DRP-Prishtina	2532	202	8
DRP-Prizren	2838	42	1.5
DRP-Ferizaj	1396	30	2.1
DRP-Mitrovica e V ¹²	9	3	33.3
Total	17278	373	2.1

3.4.4 Në tabelën në vijim është paraqitur numri i rasteve të raportuara të përdorimit të forcës nga policia në raport me numrin e personave të arrestuar për vitin 2013, sipas stacioneve policore të cilat janë përfshirë në planin e inspektimit në fushën e trajnimeve të përdorimit të forcës dhe njohurive të zyrtarëve policor mbi përdorimin e forcës. Në të dhënat e prezentuara pasqyrohet performanca e treguar për secilin stacion policorë të inspektuar. Shikuar nga ky kontekst, del se është mjaftë e ulët shkalla e raportimit të përdorimit të forcës krahasuar me

¹¹ Të dhënat statistikore janë siguruar nga Drejtoritë Regjionale të PK-së gjatë fazes së inspektimit në teren;

¹² Të dhënat për DRP Mitrovica e Veriut mungojnë për shkak se kjo e fundit në vitin 2013 është krijuar si Drejtori e ndarë nga Drejtoria Rajonale e Mitrovicës;

numrin e personave të arrestuar kur merren për bazë arsyet e cekura në paragrafin më parë. Sipas këtij krahasimi prinë Stacioni Qendra i Prishtinës me shkallë më të lartë prej 37.7 % pasuar nga Mitrovica e Jugut me shkallë prej 6 %. Po ashtu ka raste kur gjatë gjithë vitit 2013, nuk ka pasur asnjë raportim të përdorimit të forcës edhe përkundër faktit që ka pasur numër të konsiderueshëm të përdorimit të forcës siç është rasti i Stacionit të Malishevës. Shih tabelën në vijim:

Tabela nr.5 Krahasimi i rasteve të raportimit të përdorimit të forcës me numrin e personave të arrestuar për vitin 2013, sipas stacioneve policore që janë inspektuar¹³			
Stacioni	Numri i të arrestuarve	Rastet e raportuara të përdorimit të forcës	%
Gjilan	326	11	3.4
Kamenicë	324	4	1.2
Ferizaj	1113	25	2.2
Shtime	55	1	1.8
Kaçanik	105	4	3.8
Prishtinë Qendra	106	40	37.7
Prishtinë Veriu	114	3	2.6
Lipjani	154	7	4.5
Mitrovicë Jugu	332	20	6
Vushtrri	1587	13	0.8
Skenderaj	1024	5	0.5
Prizren	1118	12	1.1
Malishevë	524	0	0
Peja	1271	6	0.5
Gjakovë	2881	9	0.3
Mitrovicë Veriu ¹⁴	9	3	33.3
Zveçan	77	0	0.
Gjithsejt	11.120	163	1.5

3.4.5 I gjithë personeli i PK-së, ka qasje në data bazën elektronike dhe intranet i cili brenda vetës përmban të gjithë bazën ligjore duke përfshi edhe Udhëzimin Administrativ i cili rregullon çështjen e përdorimit të forcës. Mirëpo, shkallën e ulët të raportimit të përdorimit të forcës, menaxherët policorë e shpjegojnë për shkak të hapsirës ligjore ku formulari për përdorimin e forcës nuk e parasheh plotësimin e saj në rrethana kur zyrtarët policor bëjnë arrestimin e personave me mjete pranguese.

3.4.6 Nga intervistat me menaxherët policor nëpër stacione policore thuhet se nuk ka raste kur kanë hasur se personeli i tyre ka fshehur apo ka tentur të fshehtë raportimin e përdorimit të forcës. Poashtu IPK-ja nuk ka gjetur ekzistimin e ndonjë rasti të iniciuar ndaj ndonjë zyrtari i cili ka fshehur përdorimin e forcës. Menaxherët e intervistuar pohojnë se nëse do të ndodh një gjë e tillë në praktikë ndaj secilit zyrtar që tenton të fshehtë raportimin e forcës, iniciohet procedurë e brendshme hetimore. Po ashtu gjatë inspektimit në asnjë stacion apo njësi policore nuk është hasur se ishte iniciuar ndonjë rast ndaj zyrtarëve policorë të cilët nuk kanë përdorur forcën tek rastet e caktuara për të cilën janë të autorizuar ta aplikojnë.

¹³ Të dhënat e prezantuara në tabelë janë siguruar nga Stacionet policore të inspektuara gjatë fazës së inspektimit në teren;

¹⁴ Të dhënat për DRP Mitrovica e Veriut mungojnë për shkak se kjo e fundit be vitin 2013 është krijuar si Drejtori e ndarë nga Drejtoria Rajonale e Mitrovicës

3.4.7 Gjatë këtij inspektimi në terren nëpër stacione policore të cilat kanë qenë në programin inspektues janë marrë dhe kontrolluar gjithsej 54 kopje të dosjeve të rasteve mbi përdorimin e forcës nga policia, proporcionalisht sipas stacioneve. Përmbajtja dhe sistematizimi i shkresave të lëndës ishin po thuaj të njëjta në të gjitha DRP-të. Përmbajtja e dosjeve mbi përdorimin e forcës përmbanë: Raportin e policit mbi raportimin e përdorimit të forcës, formularin standard të përdorimit të forcës të plotësuar nga ana e mbikqyresit të drejtpërdrejt të policit të përfshirë në përdorimin e forcës, shkresat e memove të komunikimit sipas zingjirit komandues si dhe shkresat dhe kopjet e vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e rasteve të përdorimit të forcës.

3.4.8 Nëpër stacionet policore nuk ka një rregullë apo praktikë unike mbi menaxhimin dosjeve mbi përdorimin e forcës. Nuk ka kartoteka të veçanta ku mund të ruhen këto dosje ngase numri i dosjeve të rasteve të iniciuara rezulton të jetë jo i madh (sipas të dhenave nga DRP-të 373 për vitin 2013). Në disa stacione policore këto dosje ruhen në zyrat e komandantëve të stacionit dhe qasje në to kanë komandantët e stacionit, asistentët e tyre dhe zv/komandantët e stacioneve gjatë kryerjes së detyrës në mungesë të komandantëve të stacionit.

3.4.9 Po ashtu në sektorët e Administratës regjionale dallon praktika mbi menaxhimin e dosjeve të përdorimit të forcës lidhur me mbajtjen e kopjeve të tyre në kuadër të këtyre sektorëve siç ishte rasti i DRP-Ferizaj ku në sektorin e Administratës Regjionale një kopje e rastit mbahet në zyrën e shefit të këtij sektori dhe ka qasje shefi i sektorit dhe asistenti i tij si dhe një kopje e rasteve të përdorimit të forcës mbahet nëpër stacione apo njësi policore nga të cilat është iniciuar lënda për përdorimin e forcës. Ndryshe vepohet në DRP në Gjilan ku në kuadër të Sektorit të Administratës Regjionale nuk mbahet asnjë kopje e rasteve të përdorimit të forcës por shkresat e lëndës dhe dosjet mbahen vetëm në stacione apo njësi policore ku janë iniciuar rastet.

3.4.10 Evidentimi i rasteve mbi përdorimin e forcës nëpër DRP, dhe stacione të ndryshëm ndryshon ku një numër i stacioneve aplikon evidencë fizike në libra apo fletore të evidencave, disa mbajnë evidenca të thjeshta elektronike duke adaptuar ato për nevojat e tyre siç ishte rasti me DRP-Ferizaj.

3.4.11 Për plotësimin e procesit të inspektimit nëpër stacione policore të cilat kanë qenë subjekt i inspektimit në këtë fushë, është aplikuar një pyetësor i cili ju është shpërndarë zyrtarëve policor (shembuj të rastit) për vlerësimin e njohurive me rregullat dhe procedurat në fushën e përdorimit të forcës policore. Janë shpërndarë gjithsej 93 pyetësor që janë plotësuar nga 93 zyrtarë policor. Përcaktimi i numrit të plotësimit të pyetësorëve nëpër DRP-ve, është bërë duke u bazuar në numrin e rasteve të raportuara mbi përdorimin e forcës nga viti paraprak që i kanë prezantuar këto drejtori. Nga totali i përgjigjeve të nxjerra del se 49.9% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive (të sakta) kurse 50.11% e përgjigjeve kanë qenë negative (jo të sakta).

Në tabelën në vijim janë të prezantuara rezultatet nga pyetësorët që janë plotësuar nga zyrtarët policor e që si tematikë kanë pasur fushën e përdorimit të forcës.

Tabela nr.6 Rezultatet e njohurive të zyrtarëve policor të treguar në pyetësin për rregullat e përdorimit të forcës nga policia					
Drejtoria	Numri i Pyetsorëve dhe i pyetjeve	Numri i përgjigjeve pozitive	%	Numri i përgjigjeve negative	%
DRP-Mitrovica e Jugut	15x10=150	85	56.7	65	43.3
DRP-Gjilani	15x10=150	72	48	78	52
DRP- Peja	12x10=120	51	42.5	69	57.5
DRP-Prishtina	20x10=200	102	51	98	49
DRP-Prizren	9x10=90	48	53.3	42	46.7
DRP-Ferizaj	10x10=100	44	44	56	56
DRP-Mitrovica e Veriut	12x10=120	62	51.7	58	48.3
Total	93x10=930	464	49.9	466	50.1

3.4.12 Ky rezultat i nxjerrë tregon nivelin e njohurive të zyrtarëve policorë me rregullat dhe procedurat e përdorimit të forcës nga zyrtarët policor. Shikuar sipas DRP-ve, Mitrovica e Jugut ka treguar performancë më të mirë me 56.7% të përgjigjeve pozitive (të sakta) pasuar nga Prizreni me 53.3% Mitrovica e Veriut me 51.7% si dhe ajo e Prishtinës me 51%. Ndërsa performancë më të ulët të përgjigjeve të sakta kanë treguar DRP-të në Pejë me 42.5%, a Ferizaji me 44%, dhe Gjilani 48%.

4. PËRFUNDIMET

4.1 Nga inspektimi i kryer në fushën e Trajnimeve për përdorimin e forcës dhe njohurive të zyrtarëve policor mbi përdorimin e forcës nga policia, IPK-ja ka nxjerrë në pah gjendjen aktuale të funksionimit të Policisë së Kosovës, duke identifikuar punën dhe praktikën e mira që aplikon kjo organizatë. Po ashtu janë evidentuar vështirësitë dhe ngeçjet me të cilat ballafaqohet Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe aktivitetit policor dhe pas vlerësimit të gjendjes në teren, IPK-ja ka dhënë rekomandime të nevojshme menaxherëve të strukturës policore, që janë kompetent për marrjen e veprimeve drejtë përmirësimit të performancës policore.

4.2 Udhëzimi Administrativ 02/2012 i cili rregullon Përdorimin e forcës nga zyrtarët policor ka lënë hapësirë trajtimi tek qështja e forcës fizike si kategori e përkufizimit të përdorimit të forcës. Andaj, si rrjedhojë e kësaj hapësire të trajtimit ligjor ky dokument ka bërë që të ketë mospërputhje në mes përkufizimit të përdorimit të forcës fizike, raportimit të përdorimit të forcës dhe formularit të përdorimit të forcës.

4.3 Vlen për tu theksuar që hapësira ligjore, dhe mospërputhshmëria në mes rregullave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ, në veçanti ka shkaktuar konfuzitet tek raportimi i përdorimit të forcës, si dhe tek rrethanat kur zyrtarët policor kanë përdorur mjetet pranguese si pajisje policore e të cilat gjithashtu bëjnë pjesë tek kategorizimi i përkufizimit të përdorimit të forcës.

4.4 Përmbledhja e dokumenteve ligjore që rregullojnë fushën e përdorimit të forcës përcjellat me mungesë të një Procedure Standarde të Operimit e cila do të detajonte qartë hapat procedural që duhet ndërmarrë zyrtarët policor pas përdorimit të forcës.

4.5 Drejtoria Rajonale Mitrovica-Jug dhe Drejtoria Rajonale Ferizaj ka pasur një realizueshmëri më të ultë të programit trajnues të Riçertifikimit i cili brenda vetës përmban çështjen e trajtimit të përdorimit të forcës. Duhet theksuar se Drejtoria Rajonale Mitrovica-Veriu, nuk ka realizuar programin e ricertifikimit si rezultat i krijimit të një periudhe më të vonshme të saj si drejtori.

4.6 Trajnimet e obliguara që realizohen brenda DRP-ve, e që dalin si rezultat i nevojave të paraqitura, tek Drejtoria Rajonale Pejë dhe Drejtoria Rajonale Ferizaj kanë pasur fond më të ultë të orëve që trajtojnë temat në fushën e përdorimit të forcës.

4.7 Disproporcioni në mes numrit të personave të arrestuar dhe numrit të rasteve të raportuara për përdorim force në të gjitha DRP-të, është shkaktuar si rezultat i hapësirave ligjore apo mospërputhshmërisë së rregullave në udhëzimin administrativ 02/2012 që rregullon çështjen e përdorimit të forcës.

4.8 Menaxhimi i dosjeve të përdorimit të forcës në të cilën përfshihet evidentimi dhe arkivimi, nuk bëhet në mënyrë të njëjtë nëpër drejtori rajonale apo më konkretisht të gjitha Drejtoritë Rajonale Policore nuk kanë të krijuar një sistem të unifikuar lidhur me këtë çështje.

5. REKOMANDIMET:

1. *IPK-ja, Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që sa ma parë që është e mundur të udhëzoj azhurnimin e Udhëzimit Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë, në mënyrë që të bëhet harmonizimi i plotë mes normave të këtij udhëzimi si dhe formularit për raportimin e përdorimit të forcës.*
2. *IPK-ja Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe Drejtorëve të DRP-ve që të angazhohen më shumë rreth ngritjes së realizueshmërisë së vijimit të kursit të ricertifikimit për personelin policor në kuadër të stacioneve dhe njësisve që operojnë në kuadër të këtyre Drejtorive.*
3. *IPK-ja rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së dhe Divizionit të Trajnimeve që për personelin e inkuadruar në kuadër të DRP- Mitrovica e Veriut të merren veprimet e nevojshme që personeli i kësaj Drejtorie (zyrtarët policor të integruar në PK) të pajiset me trajnime shtesë me qëllim të arritshmerisë dhe përfitimit të njohurive për kryerjen e detyrave dhe përmirësimit të performancës policore.*
4. *IPK-ja Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që sa ma parë që është e mundur të udhëzoj hartimin e një Procedurë Standarde të Operimit që do ta rregullonte qartë hapat dhe veprimet policore në fushën e aplikimit të përdorimit të forcës dhe raportimit të saj.*
5. *IPK-ja rekomandon menaxherët e stacionëve policore që të inkurajojnë dhe kërkojnë përgjegjësi dhe llogaridhënje nga vartësit e tyre për zbatimin e rregullave ligjore që dalin nga Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 Për përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë, në mënyrë që çdo rast i përdorimit të forcës nga policia sipas rregullave dhe procedurave të shkruara të raportohet sipas zingjirit komandues.*
6. *IPK-ja rekomandon Shefat e Divizioneve të Administratës nëpër Drejtori Regjionale të PK-së që të aplikojnë arkivimin e dosjeve të rasteve të përdorimit të forcës në kuadër të këtyre sektorëve pavarësisht ruajtjes së tyre nëpër stacione apo njësi nga të cilat është iniciuar rasti.*
7. *IPK-ja rekomandon Drejtoritë Regjionale të PK-së që të aplikojnë programe trajnuese në fushën e përdorimit të forcës, në kuadër të trajnimeve të brendshme me qëllim të plotësimit dhe rifreskimit më të shpeshtë të njohurive të zyrtarëve policorë me rregullat dhe procedurat policore për përdorimin e forcës nga policia.*

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJËN E REKOMANDIMEVE
“Vlerësimi i trajnimit dhe njohurive të zyrtarëve policor lidhur me përdorimin e forcës”

N r.	Rekomandimi	Prioritet	Komentet	Plani i veprimit
1	IPK-ja, Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që sa ma parë që është e mundur të udhëzoj azhurnimin e Udhëzimit Administrativ 2/2012 Për Përdorimin e forcës nga ana e zyrtarëve policorë , në mënyrë që të bëhet harmonizimi i plotë mes normave të këtij udhëzimi si dhe formularit për raportimin e përdorimit të forcës.			E përfunduar.
2	IPK-ja Rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe Drejtorëve të DRP-ve që të angazhohen më shumë rreth ngritjes së realizueshmërisë së vijimit të kursit të ricertifikimit për personelin policor në kuadër të stacioneve dhe njërive që operojnë në kuadër të këtyre Drejtorive.	<i>I tërë rekomandimi</i>	<i>Do ti kushtojmë rëndësi ngritjes se nivelit te pjesëmarrjes ne ricertifikim me theks te veçante ne Rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës duke i mbështet me te gjitha resurset e nevojshme me njerëz dhe pajisje si dhe mbikëqyrë me qellim te ngritjes se % se pjesëmarrjes</i>	<i>Veprimet do te fillojnë nga Tetori dhe do të jenë në vazhdimësi</i>
3	IPK-ja rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së dhe Divizionit të Trajnimeve që për personelin e inkuadruar në kuadër të DRP- Mitrovica e Veriut të merren veprimet e nevojshme që personeli i kësaj Drejtorie (zyrtarët policor të integruar në PK) të pajiset me trajnime shtesë me qëllim të arritshmërisë dhe përfitimit të njohurive për kryerjen e detyrave dhe përmirësimin të performancës policore.	<i>I tërë rekomandimi</i>	<i>Do të fillojmë me kursin Bazik për të gjithë policët, posaçërisht me policët e integruar. Trajnime te specializuara, trafik, hetime , dhe fusha te tjera.</i>	<i>Plani i veprimit është duke u punuar nga grupi punues për policët integrues . Pasi të finalizohet do të fillojmë implementimin nga Tetori dhe do të jetë në vazhdimësi.</i>

4	IPK-ja Rekomandon Drejrotit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që sa ma parë që është e mundur të udhëzoj hartimin një Procedurë Standarde të Operimit që do ta rregullonte qartë hapat dhe veprimet policore në fushën e aplikimit të përdorimit të forcës fizike dhe raportimit të sajë.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>E parapare te përfundohet deri me 15 Dhjetorë 2014.</i>
5	IPK-ja rekomandon menaxherët e stacioneve policore që të inkurajojnë dhe kërkojnë përgjegjësi dhe llogaridhënie nga vartësit e tyre për zbatimin e rregullave ligjore që dalin nga Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 Për përdorimin e forcës fizike nga ana e zyrtarëve policorë, në mënyrë që çdo rasti përdorimit të forcës nga policia sipas rregullave dhe procedurave të shkruara të raportohet sipas zinxhirit komandues.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Shtator</i>
6	IPK-ja rekomandon Shefat e Divizioneve të Administratës nëpër Drejtori Regjionale të PK-së që të aplikojnë ruajtjen arkivimin e dosjeve të rasteve të përdorimit të forcës në kuadër të këtyre sektorëve pavarësisht ruajtjes së tyre nëpër stacione apo njësi nga të cilat është iniciuar rasti.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Shtator</i>
7	IPK-ja rekomandon Drejtoritë Regjionale të PK-së që të aplikojnë programe trajnuese në fushën e përdorimit të forcës, në kuadër të trajnimeve të brendshme me qëllim të plotësimit dhe rifreskimit me të shpeshtë të njohurive të zyrtarëve policorë me rregullat dhe procedurat policore për përdorimin e forcës nga policia.	<i>I tërë rekomandimi</i>		<i>Muaji Dhjetor</i>